

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
NR. 603 REP. 62 KOL.



KONTRATE SHITJE KUOTASH

Ne Tirane, sot ne date 23.02.2007 (dymije e shtate) para meje Noteres LINDITA P.KOKONA, ne zyren time noteriale ne Bulevardin "Gjergj Fishta", u paraqiten personalisht palet, me cilesine e shitesit dhe te blesesit, te cilet ne baze te nenit 705 e vijues te Kodit Civil si dhe te Ligjit "Per shoqerite tregtare", kerkuan redaktimin e kesaj kontrate si vijon:

SHITES :HALIM MEHMETI i biri i Shaqirit, datelindja 13.04.1955, banues ne Tirane , madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar nga pasaporta personale.

BLERES : FETI MEHMETI i biri i Shaqirit, datelindja 14.01.1950, banues ne Tirane , madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar nga pasaporta Nr.Z1659817.

EQEREM MEHMETI, i biri i Shaqirit, datelindja 14.05.1959, banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar nga pasaporta personale.

OBJEKTI : Shitjen e 23 % te kapitalit te shoqerise "BLE-KLO-AR" Shpk, me seli ne Cerrik, Lagja Nr.1 Ish Fabrika e Bukes, ne mbeshtetje te ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe dispozitave perkatese te statutit te Shoqerise.

Sipas verifikimit te dokumentacionit te paraqitur deri ne ditën e sotme te Shoqerise " BLE-KLO-AR" Shpk, shoqeri kjo e rregjistruar si person juridik me Vendim te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane me Nr.16616 date 09.01.1997, rezulton qe Z.Feti MEHMETI, Z.Eqerem MEHMETI dhe Z.Halim MEHMETI jane Ortake te Shoqerise, duke zoteruar perkatesisht 34 %, 33% dhe 33 % te kapitalit te kesaj shoqerie, kapitali i cili aktualisht eshte 10898543 lek.

Ne mbeshtetje te ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite Tregtare", dhe te neneve perkates te Statutit te Shoqerise " BLE-KLO-AR " Shpk, palet e mesiperme kane rene dakort midis tyre per shitblerjen e pjeseve te kapitalit te ortakeve te shoqerise. Z.Halim MEHMETI i shtet Z.Feti MEHMETI 16 % te kuotave te shoqerise me nje vlere prej 174376.68 (njqind e shtatedhjete e katermije e treqind e shtatedhjete e gjashte pik gjashtedhjete e tete) lek , si dhe Z.Eqerem MEHMETI 7% te kuotave te shoqerise me nje vlere prej 762898.01(shtateqind e gjashtedhjete e dy mije e teteqind e nentedhjete e tete pik zero nje) lek, shume e cila eshte likujduar plotesisht nga palet jashte kesaj zyre noteriale.

Me nenshkrimin e kesaj kontrate shitje, shitesi e humbet te drejten e pronesisë mbi 16% te kuotave duke mbetur zoterues i 10% te kuotave te shoqerise, ndersa blesesit behen zoterues : Feti MEHMETI i 50% te kapitalit te shoqerise, dhe Z.Eqerem MEHMETI behet zoterues i 40% te kapitalit te shoqerise "BLE-KLO-AR" Shpk .

Kontrata e mesiperme u perpilua nga une noterja dhe pasi u lexua dhe u gjet sipas vullnetit te lire e te plote te paleve nenshkruhet prej tyre dhe vertetohet nga une noterja sipas ligjit.

SHITES

BLERES

Halim Mehmeti
[Handwritten signature]

NOTER PUBLIK
LINDITA KOKONA

[Handwritten signature of Lindita Kokona]

Feti Mehmeti
[Handwritten signature]

Eqerem Mehmeti
[Handwritten signature]